



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.2.2023

Nr: 40

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË BASHKISË BERAT, PËR
PERIUDHËN 20 JANAR – 23 JANAR 2023**

Sot, më datë 8.2.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Berat

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat për periudhën 20 janar deri më 23 janar 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 21, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës së monitorimit 20 janar deri më 23 janar 2023, Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 2 veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

Data: 8.2.2023 Nr: 40
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat, për periudhën 20 janar – 23 janar 2023”

- Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.1.2023,
- Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.1.2023,

Me shkresën nr. 461 prot., në datë 28.1.2023, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Berat , informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 1.2.2023, ora 10:30.

Pas njoftimit të kryer, Bashkia Berat ka depozituar pretendime pranë KQZ-së, duke sqaruar se: *“Aktivitetet janë zhvilluar me disa biznese për tu njohur me shqetësimet dhe problematikat e tyre në lidhje me punimet që zhvillohen në atë zonë dhe se ky kontaktim me ta nuk ka qenë i karakterit politik. Gjithashtu këto takime janë zhvilluar me një staf shumë të vogël i bashkisë dhe nuk ka pasur pjesëmarrës të tjerë (1 -2 dhe jo më shumë vetë). Nuk kanë qenë të planifikuara si vijim i punës rutinë të bashkisë dhe stafit të saj. Gjithashtu bashkia Berat ka pasur probleme me rrjetin e brendshëm kompjuterik e cila ka penguar realisht deklarin e këtyre dy takimeve”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet krijoi bindjen se aktivitetet janë raportuar jashtë afatit ligjor pa asnjë shkak të justifikuar.

Nisur nga tematika e tyre të dyja aktivitetet janë raportuar në ndërfaqe si veprimtari të hapura dhe me pjesëmarrje të publikut. Referuar nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor janë “veprimtari publike”, të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit ligjor të përcaktuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI